

VENDIM
Nr.493, datë 25.7.2007

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË KRITEREVE DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT
PËR REZULTATE TË LARTA NË ARTIN SKENIK, TË ARRITURA NË KONKURRIME
NDËRKOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e autorëve, krijues dhe interpretues, të artit skenik, për rezultate të larta, të arritura në konkurrime ndërkombëtare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, me urdhër të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Ky shpërblim përfitohet nga autorët, krijues dhe interpretues, që kanë marrë çmim të parë në veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim te Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë autori, krijues apo interpretues, për përfitimin e shpërblimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, janë:

a) Të ketë marrë pjesë në veprimtari të më të rëndësishme evropiane dhe botërore, të njohura zyrtarisht nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet qendrore publike të artit skenik, në varësi të kësaj ministrie;

b) Pas një përzgjedhjeje serioze nga juritë ndërkombëtare të ketë fituar çmimin dhe të jetë i shpallur publikisht fitues nga organizatorët e veprimtarisë;

c) Çmimi të jetë i shoqëruar me diplomën apo certifikatën përkatëse, të noterizuar, dhe me dokumente të tjera zyrtare, si dhe me publikimet për jehonën e veprimtarisë, në median e shkruar të vendit, ku zhvillohet veprimtaria ndërkombëtare.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha